
LEGJISLACIONI DHE MJETET E DHUNËS SË PUSHTETIT NË SHQIPËRINË E PASLUFTËS 1944-1946

FLORIN ZYBERAJ *

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit

florin.zyberaj@hotmail.com

Abstrakt:

Kur flasim për represionin komunist, duhet të kemi parasysh sistemin ligjor dhe ligjet e para represive të miratuara në vitet 1944-1946 që shërbyen si “praktika” mbi të cilat merreshin masa ndaj kundërshtarëve politikë. Krahës ligjeve represive, arrestimet, operacionet ndëshkuese, aksionet kundër të arratisurve të dëshmuara nga dokumentacioni arkivor shqiptar (AMB, AQSH, ASHV-të) kanë një rëndësi të veçantë në zbardhjen e krimeve të kryera në periudhën e komunizmit.

Fjalë kyçe: *Shqipëri, represion, regjimi komunist, Divizioni i Mbrojtjes së Popullit, Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit etj.*

Hyrje

Fillesat e represionit komunist në Shqipëri i gjejmë që gjatë Luftës së Dytë Botërore, por edhe pas saj. Represioni është mjaft i dukshëm në mbledhjen dhe vendimet e Kongresit të Përmetit, 24-28 maj 1944. Në këtë kongres përfaqësohej vetëm një forcë politike: Lëvizja Nacionalçlirimtare nën drejtimin e Partisë Komuniste Shqiptare. “Si i tillë ai nuk mund të ishte demokratik, dhe nuk mund të kishte tagër të ligjësonte një pushtet të vetëm në Shqipëri, aq më tepër në rrethana lufte”.¹ Kongresi formoi organizma të tillë që garantonin pushtetin e një force të vetme politike, duke përjashtuar forcat e tjera që vepronin në Shqipëri. Kongresi

* **Student i shkollës doktorale.** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë.

1 *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX (1939-1944)*, Vëll. IV (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2021), 355.

ndër të tjera zgjodhi edhe Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar, si organin më të lartë përfaqësues legjislativ.

Ndër vendimet që u morën në këtë kongres, ishin vazhdimi i luftës kundër ushtrisë gjermane deri në çlirimin e vendit, si dhe të vazhdohej më e rreptë lufta civile ose, siç cilësohej, lufta kundër “tradhtarëve” e cila përveç forcave të grumbulluara rreth qeverisë kuislinge të Tiranës dhe Ballit Kombëtar, tashmë drejtohej edhe kundër forcave të Legalitetit dhe grupeve të tjera nacionaliste që nuk kishin bashkëpunuar me gjermanët, madje një pjesë ishin angazhuar në luftime kundër tyre.

Edhe në diskutimet e Plenumit të dytë të KQ-së të PKSH-së, Berat 23-27 nëntor 1944, dëshmohet vijimi i sistemit represiv dhe demaskimi politik i kundërshtarëve të PKSH-së, si e vetmja rrugë në forcimin e pozitave të Partisë Komuniste. Jo vetëm demaskimi i kundërshtarëve të PKSH-së, por kishte filluar edhe vrasja brenda llojit të tyre, siç është rasti i Mustafa Gjinishit. Në këtë Plenum, Sejfulla Malëshova ndër të tjera theksoi se *“ne po i zgjidhim punët me terror dhe se terrori zë vend të madh në punën tonë politike...po shfaqen simptomat e degjenerimit nga një parti politike në një bandë kriminelësh”*.² Teksa shfletojmë dokumentacionin arkivor shqiptar për vitet 1944-1946, shohim një nxitim të pashpjeguar nga ana e kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ) në miratimin e disa ligjeve që në thelb ishin ligje represive dhe ndëshkuese, që filluan të aplikoheshin akoma pa mbaruar lufta, si dhe në periudhën e pasluftës. Këto ligje i shërbyen Partisë Komuniste si instrumente për të vendosur sundimin e saj, autoritar e diktatorial.

Studiuesi amerikan, Christian Davenport, represionin e cilëson si formën kryesore të aplikimit të dhunës shtetërore ndaj të drejtave bazike të individit, të nivelit të parë. Në të drejtat e nivelit të parë, Davenport përfshin: a) *Lirinë e shtypit, asamblesë dhe udhëtimit*, b) *Lirinë e shoqërimit dhe besimit pa reprezalje qeveritare, bllokim ose hetim, përveç nëse lidhet qartë me shkelje të mundshme të ligjeve qeveritare*, c) *lirinë e përgjithshme për bojkot, protestë paqësore, ose grevë pa vuajtur dënime penale ose civile*.³

Represioni është lidhur ngushtë me regjimet diktatoriale, pasi, siç nënvizon edhe politologu Giovanni Sartori, diktatura është një sundim jokushtetues. Sipas tij, sunduesit bëjnë një kamuflim të një kushtetute paraekzistuese ose ata shkruajnë një kushtetutë që e fuqizon pushtetin, në praktikë, sipas dëshirës së tyre. Nga ky këndvështrim, struktura e diktaturave mund të cilësohet si e kundërta e strukturave

² Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/AP-ou, Viti (më tej: V.) 1944, Dosja (më tej: D.) 2/1, Fleta (më tej: fl.) 57-58. Mbledhja e Komitetit Qendror të Partisë në Berat, 23 nëntor 1944.

³ Christian Davenport, “State Repression and Political Order”, Annual Review of Political Science Vol. 10, 2007, 2.

kushtetuese.⁴

Ky studim vë në fokus rëndësinë që kishte për KANÇ-in dhe qeverinë provizore shqiptare miratimi i një korpusi ligjor; mjetet e dhunës së pushtetit dhe veprimtarinë e Komisionit Qendror për kriminelët e luftës (KQKL). Për Partinë Komuniste, krijimi i një korpusi ligjor ishte një domosdoshmëri, jo vetëm nga ana juridike. Përmes një logjike duhej të ngurtë të kopsiteshin aktet ligjore dhe nënligjore me të cilat arsyetonin dënimet kryesisht ndaj kundërshtarëve politikë.

Komisioni Qendror për kriminelët e luftës, ngritur më 22 dhjetor 1944, iu largua qëllimit fillestar: zbulimin dhe hetimin e gjithë personave që kishin kryer ‘krime lufte’ pa dallime politike. Nga një komision kundër kriminelëve të luftës, u kthye në një komision kundër kundërshtarëve të PKSH-së dhe qeverisë komuniste.

Por, duke e njohur në thelb ideologjinë komuniste, personalitetet e kohës të cilët kishin kundërshtuar ardhjen e komunistëve në pushtet, si: Mid’hat Frashëri, Qazim Mulleti, Mustafa Kruja, Xhelal Mitrovica, Abas Ermenji, Ali Këlcyra etj u arratisën nga Shqipëria. Menjëherë pas lufte, “*Shqipëria i bëri një kërkesë OKB-së për t’i dorëzuar të ashtuquajturit “Kriminelë lufte”, një pjesë e konsiderueshme e të cilëve strehoheshin në Itali, Greqi, Austri, Gjermani*”.⁵ Sipas historianes Enriketa Pandelejmoni, - kërkesa e Shqipërisë pas shumë kërkesash ndër vite ndaj Komisionit të Kombeve të Bashkuara nuk u plotësua me arsyen e thjeshtë, se këta njerëz do të ekzekutoheshin me të vënë këmbë në Shqipëri.⁶

Duhet nënvizuar fakti se fitorja e luftës dhe ardhja në pushtet e komunistëve nuk konsiderohej si e plotë. Fitore për ta, pas lufte ishte mbrojtja e pushtetit dhe garantimi i vijueshmërisë së qeverisjes së vendit. Për të garantuar mbrojtjen e pushtetit, regjimi krijoi dy organe besnike të saj: Divizionin e Mbrojtjes së Popullit dhe Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit.

Divizioni i Mbrojtjes së Popullit nuk duhet ngatërruar me Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit. Divizioni i Mbrojtjes së Popullit dallon me Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit, ndonëse të dyja strukturat kishin një synim të përbashkët: mbrojtjen e pushtetit, mbajtjen në këmbë dhe forcimin e regjimit komunist. Divizioni i Mbrojtjes së Popullit është një strukturë operacionalo-ushtarake dhe operative që ka funksionuar nga dhjetori i vitit 1944 deri në vitin 1949. Në vitin 1948, DMP-ja figuron me emrin “Divizioni i Mbrojtjes së Popullit “Enver”. Divizioni, varej nga Komanda e Përgjithshme e Forcave të Armatosura dhe mbante lidhje të ngushta

⁴ Giovanni Sartori, *The Theory of Democracy Revisited* (New Jersey: Chatham House Publishers, 1987), 205.

⁵ Enriketa Pandelejmoni, “*Kriminelët e luftës*”: *emigracioni politik shqiptar në Itali dhe raporti me shtetin komunist shqiptar 1945-1955*”, në: *Emigracioni politik shqiptar në vitet 1944-1990* (Tiranë: Onufri, 2021), 42-43.

⁶ Pandelejmoni, “*Kriminelët e luftës*”: *emigracioni politik shqiptar në Itali dhe raporti me shtetin komunist shqiptar 1945-1955*”, 42.

me organet e Sigurimit të Shtetit dhe forcat e policisë. Divizioni ishte në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare, por nga ana operative varej nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).⁷

Ndërsa Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit ishte shërbim sekret. Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit është krijuar më 10 dhjetor 1944 sipas modelit të OZNA-s jugosllave dhe drejtohej nga Koçi Xoxe.⁸ Pranë saj, ishin ngritur disa seksione: Seksioni i zbulimit politik, Seksioni i kundërzbulimit (informacioni) me disa sektorë, Seksioni kundër të huajve, Seksioni i mbrojtjes së popullit për ruajtjen e rradhëve të ushtrisë, Seksioni i kartotekave (evidenca operative), dhe Seksioni i vëzhgimit dhe sekretaria. Struktura organizative e Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit në harkun kohor 1944-1946 është ndryshuar. Deri në fundin e vitit 1945, Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit ishte në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, por në vitin 1946 iu ndryshua emërtesa dhe u quajt Drejtoria e Sigurimit të Shtetit dhe kaloi nën varësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

1. Sistemi ligjor: ligjet represive

Kongresi i Përmetit (24-28 maj 1944) zgjodhi Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ) si trupin kryesor legjislativ dhe ekzekutiv përfaqësues të sovranitetit të popullit dhe të shtetit shqiptar.⁹ Ishte pikërisht kryesia e KANÇ-it organi suprem që bënte ligjet. Përgjatë vitit 1944-1945, hapi i parë që hodhi regjimi i ri drejt organizimit të sistemit ligjor dhe gjyqësor ishte nxjerrja dhe shpallja e disa ligjeve.

Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, me vendim nr. 8, datë 29 maj 1944 vendosi që të formohej pranë Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar një komision i shtetit për zbulimin dhe vërtetimin e krimeve të okupatorit dhe bashkëpunorëve të tij, gjithashtu për zbulimin dhe vërtetimin e emrave të të gjithë

⁷ Florin Zyberaj, *Dokumente mbi Divizionin e Mbrojtjes së Popullit 1944-1946*, Vëll. I (Tiranë: ISKK, 2022), 39.

⁸ Arkivi i Ministrisë së Brendshme (më tej: *AMB*), Fondi (më tej: *F.*) 4/shtabi, Viti (më tej: *V.*) 1948, Dosja (më tej: *D.*) 23, Fleta (më tej: *fl.*) 14; *AQSH*, F. 411/AP, V. 1949, D. 6, fl. 4. Pjesë nga deponimi i Vaskë Kolecit në komisionin hetimor, më 15 janar 1949.

⁹ Luan Dode, *Partia Komuniste Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore (nëntor 1941 - nëntor 1944): rrënjët e diktaturës komuniste në Shqipëri* (Tiranë: ISKK, 2020), 256; Bernd J. Fischer, *Shqipëria 1943-1945: një vështrim përmes dokumenteve perëndimore* (Tiranë: AIIS, 2012), 71.

kriminelëve të luftës, si dhe vetë Kryesia do të emëronte anëtarët e këtij komisioni.¹⁰

Më 15 dhjetor 1944, “*Kryesia e KANÇ vendosi krijimin e gjyqeve speciale për kriminelët e luftës, shqiptarë ose të huaj, dhe për gjykimin e tyre do ngriheshin gjyqe speciale pranë çdo prefekturë*”.¹¹ Kryesia e KANÇ-it me “*ligjin nr. 25, datë 15 dhjetor 1944, vendosi të konfiskoheshin pasuritë e tundshme dhe të patundshme të të arratisurve politikë*”.¹²

Po në këtë datë u nxorën dhe dy ligje: “*Ligji nr. 20 mbi ndalimin e eksportimit të metaleve me vlef të (ar dhe argjend, palatin e gur të çmuar) në çdo trajtë si monedhë, shufër, sende stolije etj dhe mbi ndalimin e eksportimit të prodhimeve të tokës dhe të prodhimeve të fabrikuese*”.¹³ Sipas këtij ligji ndalohej rreptësisht eksportimi i metaleve të çmuara, prodhimeve bujqësore dhe për çdo moszbatim të këtij ligji kishte pasoja, të cilat shkonin nga burgim me 1-30 vite, burgim i përjetshëm e deri te dënimi me vdekje, si dhe me konfiskim të pasurisë të tundshme dhe të patundshme dhe me humbje të të drejtave civile dhe politike. Ligji nr. 21 mbi “*sabotorët e luftës dhe të pushtetit të popullit, mbi ata që fshehin kriminelët e luftës dhe gjithë ata që ndiqen prej ligjit ose kanë dije për këta dhe nuk tregojnë, si dhe mbi ata që vjedhin pasurinë e shtetit dhe të popullit, mbi spekulatorët, falsifikatorët, mbi ata që fshehin sende të domosdoshme për ushqimin dhe strehimin e popullit dhe për rindërtimin e vendit*”.¹⁴

Më 18 dhjetor 1944, u krijuan komisionet vendore për studimin dhe administrimin e pasurive të të arratisurve pranë komiteteve ekzekutive të prefekturave [...].¹⁵

Më 22 dhjetor 1944, në Tiranë, për hetimin e krimeve të Luftës u formua një komision i quajtur *Komisioni Qendror për zbulimin e krimeve, të kriminelave të luftës dhe t'armiqve të popullit*. Në çdo prefekturë dhe nënprefekturë u krijuan

¹⁰ AQSH, F. 40/APL, V. 1944, D. 19, fl. 3. Vendim i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Shqipërisë për themelimin e komisionit të shtetit, pranë KNÇ.

¹¹ AQSH, F. 40/APL, V. 1944, D. 37, fl. 1. Vendim i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Shqipërisë mbi krijimin e gjyqeve speciale, Tiranë më 15 dhjetor 1944.

¹² AQSH, F. 40/APL, V. 1944, D. 37, fl. 2. Vendim i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Shqipërisë mbi konfiskimin e pasurisë së tundshme dhe të patundshme të të arratisurve politikë.

¹³ “*Gazeta Zyrtare*”, V. I, nr. 2 (Tiranë: Botim i Ministrisë së Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore, 23 dhjetor 1944), 2. Ligji nr. 20 mbi ndalimin e eksportimit të metaleve me vlerë (ar dhe argjend, palatin e gur të çmuar) në çdo trajtë si monedhë, shufër, sende stolije etj, dhe mbi ndalimin e eksportit të prodhimeve të tokës dhe të prodhimeve të fabrikuara.

¹⁴ “*Gazeta Zyrtare*”, V. I, nr. 2 (Tiranë: Botim i Ministrisë së Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore, 23 dhjetor 1944), 2. Ligji nr. 21 i Kryesisë së KANÇ.

¹⁵ Alvin Saraçi, *Konfiskimi i pronës dhe grabitja e arit 1944-1955* (Tiranë: ISKK, 2012), 47.

Komisionet e Hetimit që përpilonin listat e “kriminelëve të luftës”. Manol Konomi që drejtonte KQKL-në dhe Ministrinë e Drejtësisë, në lidhje me përpilimin e listave theksonte se: *“Nuk është aspak e nevojshme që dëshmitari të ketë parë me sytë e tij faktin e raportuar, por mjafton të ketë dëgjuar të flitet mbi të në popull”*.¹⁶ Komisioni Qendror kërkonte, me firmën e Manol Konomit, kokat e “kriminelëve të luftës” që ishin arratisur nga Shqipëria. Më 26 dhjetor 1944, me anë të qarkores nr. 2, Ministria e Drejtësisë njofton të gjithë këshillat çlirimtarë të prefekturave dhe nënprefekturave për të krijuar seksione të drejtësisë provizore derisa të ngrihen gjykatat e rregullta, të cilët me anë të masave të përkoshme do të shqyrtonin çështje me karakter tepër të ngutshëm.¹⁷ Seksioni i drejtësisë pranë këshillit të prefekturave kishte rolin e apelit për vendimet e seksionit të nënprefekturave, kur palët nuk ishin dakord. Këto seksione nuk kishin atributet e një gjykate, dhe çështjet penale ishin kompetencë e gjykatave ushtarake.

Në vitin 1945 nxirret një udhëzim për formimin dhe veprimin e Komisioneve për Studimin dhe Administrimin e Pasurive të të Arratisurve Politikë në çdo prefekturë dhe nënprefekturë. *“Për të studiuar dhe për të administruar pasuritë e të arratisurve politikë, do të formohen Komisione në çdo Prefekturë dhe N/prefekturë. Këto Komisione do të formohen prej elementash që do përfaqësojnë Këshillat Nacionalçlirimtare, ushtrinë, rininë antifashiste, esnafë të vendit (bujq etj) të cilët të jenë besnikë të lëvizjes N.ÇL, si dhe prej një juristi”*.¹⁸ Këtyre komisioneve iu ishin ngarkuar disa detyra, si: të hetonin ose verifikojnë të gjitha pasuritë e të arratisurve politikë; të regjistronin dhe të përshkruanin të gjitha këto pasuritë; përshkrimet e këtyre pasurive duhej t’i përmbledhnin në raporte të veçanta për secilin rast dhe t’ia paraqisnin Komisionit Qendror për studimin dhe administrimin e pasurive të të arratisurve politikë në Tiranë, si dhe të kujdeseshin për ruajtjen e këtyre pasurive, dhe të mos lejonin përdorimin e tyre.¹⁹

Në vitin 1945, u miratuan disa ligje të nxjerra prej të cilave mund të

¹⁶ Komisioni Qendror i Kriminelëve të luftës, Instituti i Studimeve Historike “Lumo Skëndo”, i disponueshëm në: <https://www.facebook.com/institutistudimevehistorikelumoskendo/posts/pfbid02CFHYj3s5wqznys2sjBFHjBTEYGPjMJNLpëqi2zMEHtMjiG8Nph5m2DKw2f2ntDmHl>, aksesuar, më 22 dhjetor 2023.

¹⁷ Femi Sufaj, *Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri gjatë regjimit komunist 1945-1990* (Tiranë: Dita 2000, 2014), 62. Autori i referohet: *AQSH*, F. 515, V. 1944, D. 2, fl. 2.

¹⁸ Arkivi Shtetëror Vendor Dibër (më tej: *ASHV/Dibër*), Fondi (më tej: F.) 1, Viti (më tej: V.) 1945, Dosja (më tej: D.) 4, Fleta (më tej: fl.) 26. Udhëzim mbi formimin dhe veprimin e komisioneve për studimin dhe administrimin e pasurive të të arratisurve politikë.

¹⁹ *ASHV/Dibër*, F. 1, V. 1945, D. 4, fl. 26.

përmendim: Ligjin nr. 36, datë 13 janar 1945 “*mbi konfiskimin e pasurive të shtetasve italianë dhe gjermanë, që ndodhen në Shqipëri dhe mbi marrjen në kontroll të pasurive të shtetasve të tyre*”.²⁰ Ligji nr. 37, datë 13 janar 1945 “*mbi tatimin e jashtëzakonshëm për fitimet e luftës*”.²¹ Ligji nr. 40, datë 14 janar 1945 “*dispozita të përgjithshme mbi konfiskimin e pasurive private*”.²² Një ndër ligjet represive ishte edhe ligji nr. 41, datë 14 janar 1945 të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar “*Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake*”.²³ Në nenin 18 të këtij ligji thuhej:

“Gjykatat ushtarake caktojnë këto ndëshkime, si dhe merrej masa e sigurimit me: a) Vërejtje të ashpër; b) Gjykitje (në të holla, në natyrë, në punë); c) Internim; ç) Degradim ose pushim nga puna; d) Heqje nga përgjegjësia; e) Punë e detyrueshme e rëndë prej një muaji deri në dy vjet; ë) Punë e detyrueshme e rëndë prej tre muaj deri njëzet vjet; f) Konfiskim tërësor ose pjesor i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme; g) Burgim; gj) Ndëshkim me vdekje. Bashkë me këto ndëshkime gjykata mund të vendosi heqjen e nderit ushtarak, heqjen e të drejtave qytetare e politike për një kohë të caktuar ose

²⁰ “Gazeta Zyrtare”, V. II, nr. 3 (Tiranë: Botim i Ministrisë së Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore, 23 kallnor 1945), 3-4. Ligji nr. 36 i Kryesisë së KANÇ-it.

²¹ “Gazeta Zyrtare”, V. II, nr. 3 (Tiranë: Botim i Ministrisë së Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore, 23 kallnor 1945), 5-6. Ligji nr. 37 i Kryesisë së KANÇ-it.

²² “Gazeta Zyrtare”, V. II, nr. 3 (Tiranë: Botim i Ministrisë së Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore, 23 kallnor 1945), 7-8. Ligji nr. 40 i Kryesisë së KANÇ-it.

²³ “Gazeta Zyrtare”, V. II, nr. 3-bis (Tiranë: Botim i Ministrisë së Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore, 23 janar 1945), 1. Ligji i Kryesisë së KANÇ mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave ushtarake.

gjithmonë, si dhe konfiskimin e gjithë pasurisë ose një pjese të saj.”²⁴

Ligji nr. 61, datë 17 maj 1945 për abrogimin e dispozitave ligjore gjatë okupacionit dhe pavlefshmërinë e vendimeve penale të dhëna gjatë kësaj periudhe, kishin krijuar një çoroditje në organet e drejtësisë, të cilët në shumë raste nuk dinin se cilit ligj mund t’i referoheshin në përcaktimin e një vepre penale dhe në dhënien e dënimit.²⁵

Krahas këtyre ligjeve, u nxor edhe urdhëresa nr. 1, datë 19 maj 1945 e ministrit të Ministrisë së Luftës dhe Mbrojtjes Kombëtare Enver Hoxha, drejtuar të gjithë reparteve të UNÇ. Në këtë urdhëresë, E. Hoxha thekson se, - *“ndaj dezertorëve të merreshin masa dënuese të rrepta, sipas rrethanave, duke filluar me internimin e familjes, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë, deri tek djegia e banesës. Këto masa i vendosnin në zbatim organet e Mbrojtjes, dhe atje ku mungonin këto organe, vepronin organet e Ushtrisë”*.²⁶

Viti 1945 do përmbyllet me dy ligje të tjera që për nga përmbajtja ishin po aq represive sa ligjet e sipërcituara: Ligji nr. 85, datë 12 korrik 1945 *“mbi konfiskimin e pasurive të nënshtetasve të huaj që dalin jashtë shtetit pa leje”*.²⁷

²⁴ “Gazeta Zyrtare”, V. II, nr. 3-bis (Tiranë: Botim i Ministrisë së Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore, 23 janar 1945), 3-4. Ligji nr. 41 i Kryesisë së KANÇ-it mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave ushtarake. Sipas ligjit nr. 41, të 14 janarit 1945, kemi Gjykata Ushtarake të Korpusit pranë çdo Korparmte. Sipas nenit 4 të këtij ligji, këto gjykata gjykojnë të gjitha fajet penale të personave në territoret ku zhvillohen operacionet dhe kanë karakter të jashtëzakonshëm dhe të përkohshëm, deri sa të vendoset stabiliteti dhe qetësia në vend. Gjykatat Ushtarake të Krahinës së Korpusit, kanë karakter të përkohshëm dhe janë:

Gjykata Ushtarake e Korpusit të parë, zona e parë në këshillat gjyqësorë të qarkut Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Kukës, Peshkopi.

Gjykata Ushtarake e Korpusit të dytë, Berat dhe të zonës së dytë me këshillat gjyqësorë të qarkut Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë, Kolonjë, Pogradec pranë Divizionit V dhe VI. Këto gjykata ndër të tjera gjykonin “kriminelët e luftës”, “armiqtë e popullit”, ushtarakët e prapavijave etj.

[...] Sistemi i drejtësisë i ushtruar nga Gjykatat ushtarake sipas një raporti të komandës së përgjithshme të UNÇSH (seksioni juridik) ka shkaktuar vonesa në gjykimin e kriminelëve të luftës, armiqve të popullit, ushtarakëve, dhe civile; tejmbushje të burgjeve; shpenzime të mëdha për ushqimin e të burgosurve etj. - *AQSH*, F. 516, V. 1945, D. 17, fl. 1-2.

²⁵ Femi Sufaj, *Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri gjatë regjimit komunist 1945-1990* (Tiranë: Dita 2000, 2014), 63.

²⁶ *AQSH*, F. 516, V. 1945, D. 2, fl. 1. Urdhëresë nr. 1 nga Ministria e Luftës dhe e Mbrojtjes Kombëtare, dërguar gjithë reparteve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, Tiranë, më 19 maj 1945.

²⁷ “Gazeta Zyrtare”, V. II, nr. 24 (Tiranë: Botim i Ministrisë së Shtypit, Propagandës dhe

Ligji nr. 135, datë 5 nëntor 1945, *“konfiskimi i pasurisë u bë vetëm për ata që konsideroheshin bashkëpunorë me okupatorin, si dhe pjestarë të tjerë të familjeve të tyre”*.²⁸

2. Arrestimet e para politike pas çlirimit

Menjëherë pas Çlirimit represioni komunist u përqendrua kryesisht tek kundërshtarët politikë, të arratisurit, strehuesit e të arratisurve dhe ndaj individëve që nuk mbështesnin qeverinë komuniste të sapoardhur në fuqi.

Në muajin dhjetor 1944, nisi një valë arrestimesh nga ana e organeve represive si, Divizioni i Mbrojtjes së Popullit dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit. Çdo ditë vinin telegrame, radiograme dhe raporte drejtuar Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit në lidhje me arrestimet e kundërshtarëve. Në një telegram nga shefi i Seksionit të Mbrojtjes së Popullit për Tiranën, Stefo Grabocka, dërguar Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit, Tiranë, thuhet se, - të kërkuar prej kësaj komande [është fjala për komandën e qarkut Korçë] autoritetet e ELAS-it në Selanik i dorëzuan Zv. Komandantit të këtij qarku këta persona:

“1-. *Koço Kota*²⁹; *Xhavit Leskoviku*; *Haki Mulleti*; *Jonus Shijaku*; *Nexhmi Shijaku*; *Fuat Nexhmi Shijaku dhe Koço Kamenica*. *Usullë këtu dhe u burgosën. Na*

Kulturës Popullore, 24 korrik 1945), 2. Ligji nr. 85 i Kryesisë së KANÇ-it.

²⁸ Saraçi, *Konfiskimi i pronës dhe grabitja e arit 1944-1955*, 46.

²⁹ Veprimtar politik, Kryeministër i Shqipërisë (10 shtator 1928-5 mars 1930 dhe 9 nëntor 1936-7 prill 1939), ministër i Brendshëm (11 maj 1928-1 shtator 1928 dhe 5 shtator 1928-13 janar 1930). Kostaq Kota, i njohur edhe si Koço Kota, u lind në Korçë, më 1889. Më 1913 u zgjodh sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit. Më 1920 mori pjesë në Kongresin e Lushnjës. Është ndër themeluesit e Partisë Popullore në tetor 1920. Nga 1921 deri më 1923 ishte prefekt i Beratit. Më 1924-ën u zgjodh ministër i Punëve Botore. Gjatë Revolucionit të Qershorit u largua në Greqi. Pas rënies së qeverisë së Fan Nolit, u kthye në postin e tij ministror. Më vonë shërbeu si ministër i Arsimit (janar 1925), ministër i Punëve të Brendshme (shkurt-mars 1925), si kryetar i Kuvendit nga 3 tetori 1925, sërish ministër i Punëve të Brendshme (maj-shtator 1928) dhe, përfundimisht, si Kryeministër nën Mbretin Zog I (1928-mars 1930 dhe nëntor 1936-prill 1939). Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai u bashkua me Legalitetin dhe, në fund të vitit 1944, u arratis në Greqi. Por u rrëmbye prej agentëve të regjimit komunist, u kthye në Shqipëri, ku dhe u dënua me burgim, më 13 prill 1945, nga Gjyqi Special. Vdiq nga torturat në burgun e Burrelit në vitin 1949. - *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist*, Vëll. IV (I-K), (Tiranë: ISKK, 2015), 330.

*lajmëroni mënyrën e veprimit”.*³⁰

Në dhjetor të vitit 1944 Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë Nacionalçlirimtare jepeshin disa udhëzime (rregulla) për Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit mbi mënyrën sesi duhej vepruar në burgje, si dhe detyrat e personelit të burgjeve. Drejtori i burgut ishte personi kyç i cili merrte në dorëzim të burgosurit që futeshin në burg, si dhe bëhej regjistrimi i tyre.³¹

Në dhjetor të 44-ës u arrestua edhe vetë kunati i Enver Hoxhës, politikani Bahri Iljaz Omari. Më 6 dhjetor 1944 u mor në pyetje prej komisionit të Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit ku foli për bashkëpunimin me qeverinë e kryesuar nga Rexhep Mitrovica. Në këtë qeveri, Bahri Omari mbante postin e ministrit të jashtëm.³² Më tej, Bahri Omari flet edhe për mundësinë e realizimit të një Konfederate Ballkanike, për lidhjen e një marrëveshjeje me qeverinë greke ku këta të fundit të njihnin kufijtë e Shqipërisë sipas përcaktimit të 1913, si dhe pranonin që Kosova të lidhej me Shqipërinë.

Valës së arrestimeve nuk i shpëtoi as Bedri Pejani³³ i cili u arrestua nga forcat

³⁰ *AQSH*, F. 41/APL, V. 1944, D. 103, fl. 2. Telegram i Stefo Grabockës për Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit, Tiranë, 13 dhjetor 1944.

³¹ *AQSH*, F. 41/APL, V. 1944, D. 56, fl. 10-10/1. Disa nga rregullat që duhen zbatuar në burgje, përshkruar nga Komanda e Përgjithshme e UNÇSH, dërguar Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit, dhjetor 1944.

³² *AMB*, F. 1, V. 1945, D. 12551 + 1568 (Fejzi Alizoti, Terenc Toçi, Aqif Permeti, Gustav Mirdashi, Konstandin Kote, Hilmi Leka, Reshit Mërlika etj), fl. 193. **Shënim:** Komisioni hetues përbëhej prej Josif Pashkos dhe Selman Brahimit.

³³ Bedri Abdi Pejani, lindi në Kosovë më, 10 tetor 1985. Ndoqi kolegjin “Robert” në Stamboll dhe studioi për histori. Pejani shërbeu në lëvizjen nacionaliste shqiptare në rajonin e Shkupit kundër xhonturqve në vitin 1908. Ishte delegat në Kongresin e Manastirit, që nga viti 1908, dhe kryesoi Kongresin e Dytë të Manastirit. Mori pjesë në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë në nëntor 1912, duke u zgjedhur më pas në Senatin e parë shqiptar, si dhe përfaqësoi Kosovën në Konferencën e Versajës më 1919. Ishte i zgjedhuri për Kosovën në Këshillin Kombëtar Shqiptar (1921-1923), dalë nga zgjedhjet që përfunduan më 5 prill 1921. Pejani ishte një nga pjesëmarrësit në grushtin e shtetit të vitit 1924. Pas kësaj ngjarjeje, u largua nga vendi dhe iu bashkua KONARE-s (Komiteti Nacional Revolucionar). Më vonë, u angazhua në Komitetin për Çlirimin e Kosovës (Komiteti i Çlirimit të Kosovës, KÇK). Me ardhjen e Ahmet Zogut në pushtet u dënua me vdekje nga qeveria e Zogut, por më vonë u fal. Pushtimi italian i Shqipërisë, në prill 1939, i gjeti pejanët si pjesë e komunitetit shqiptar të mërguar në Liban dhe Paris. Megjithatë Pejani ishte një kundërshtar i vjetër i Zogut, ai dhe aktivistë të tjerë shqiptarë dhe politikanë francezë (si Justin Godart) mbajtën një takim proteste në Paris, më 8 prill 1939. Takimi kundërshtoi me forcë pushtimin e Shqipërisë dhe kërkoi një përgjigje nga demokracitë perëndimore. Me kthimin e tij në Shqipëri u burgos nga italianët për veprimtari antifashiste në Porto-Romano. Pas kapitullimit të Italisë u lirua.

e Mbrojtjes së Popullit dhe u mbajt në izolim. Në një njoftim të datës 25 dhjetor 1944 thuhej se mbahet i izoluar në një dhomë “*mbasi di shumë gjëra dhe ka mjaft përgjegjësi. Udhëzime pritni nga Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit*”.³⁴

Nga fillimi i vitit 1945 deri në vitin 1946, në të gjithë prefekturat e vendit u arrestuan një numër shumë i madh personash të etiketuar si “Kriminelë lufte”, “Armiq të popullit”. Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit në bashkëpunim me Divizionin e Mbrojtjes së Popullit ndërmerrnin operacione për të arrestuar kundërshtarët e regjimit, shpeshherë pa pasur prova e fakte mbi personat e ndaluar. Vetë shefi i Seksionit të Mbrojtjes së Popullit, Krahina III, Zoi Themeli, në shkresat përcjellë Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit në lidhje me të burgosurit në Burgun e Shkodrës thekson se, “*Ju paraqesim dy lista të burgosunsh prej 26 vetash s’bashku me akuza, por këto akuza janë pa baza dhe nuk faktohen, të cillët janë prej qytetit të Shkodrës, dhe që na i ka dërgue Komisioni i Hetimeve, ku thotë: se për këta, akuzat që i atribohen nuk themelohen*”.³⁵ Nga lista emërore e sipërpërmendur, ishin 21 persona të ndaluar, për të cilët u propozua të liroheshin nga burgu, ndërsa për pesë të tjerë, si: Ida Lezhja, Loro Kodheli, Xhemal Anamali, Gjush Sheldija, Muhamet Halili u

Gjatë pushtimit nazist, Mustafa Kruja dhe Shefqet Vërlaci do ta inkurajonin të merrte një rol më aktiv në politikën shqiptare. Në fillim të vitit 1944, Lidhja e Dytë e Prizrenit u përfshi nga disa ndryshime. Mbledhja e datës 17 janar 1944, zgjodhi për kryetar të lidhjes Bedri Pejanin dhe sekretar Bedri Gjinajn. Synimi kryesor ishte për të mbrojtur Shqipërinë e Madhe.

Në gusht të vitit 1941, anëtarët e deriatëhershëm të Komitetit të Kosovës, ia ndërruan emrin organizatës së tyre dhe u quajt “Lidhja Popullore Shqiptare” me seli në Mitrovicë. Në krye të lidhjes u vendos Ali-Beg Draga. Përpos tij, në udhëheqje të ngushtë ishin Xhafer Deva, Aqif Blyta, Bedri Pejani, Bedri Frashëri, Shaban Mustafa, Bajazit Boletini, Rexhep Mitrovica, Ago Agaj, Xhelal Mitrovica dhe Bedri Xhini.

Në dhjetor të vitit 1944, Pejani u arrestua nga forcat partizane shqiptare dhe do të mbahej nën vëzhgim gjatë gjithë kohës. Mbahej nën vëzhgim, pasi komunistët mendonin se kishte informacione mbi kundërshtarët në Kosovë, dhe se mund të kishte informacione mbi largimin e Xhafer Devës. Më 1 korrik 1945, B. Pejani u transferua për në Pejë të Kosovës, iu dorëzua autoriteteve jugosllave të cilat e dënuan me vdekje. Për shkak të problemeve shëndetësore u shtrua në spitalin e Prizrenit, ku dyshohet se u helmua, dhe vdiq më 6 korrik 1946. - *AQSH*, F. 210/APL, V. 1944, D. 20, fl. 5; *AMB*, F. 59, V. 1945, D. 4, fl. 42; Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005* (Tiranë: 55, 2006), 128, 511; Sinan Hasani, *Kosova: të vërtetat e mashtrimet* (Prishtinë: Rilindja, 1986), 117; *Životopis Bedri Pejani*, i disponueshëm në: https://wikijii.com/wiki/Bedri_Pejani, aksesuar më, 2 shkurt 2024.

³⁴ *AQSH*, F. 210/APL, V. 1944, D. 20, fl. 5. Njoftim i shtabit të Korparmatës I për shtabin e Brigadës I të Mbrojtjes së Popullit mbi mbajtjen nën survejim të Bedri Pejanit, Tiranë, më 25 dhjetor 1944.

³⁵ *AMB*, F. 59, V. 1945, D. 4, fl. 18.

propozua për t'u internuar.³⁶

Krahas kësaj liste, ka edhe lista të tjera po nga burgu i Shkodrës, ku një pjesë e madhe e të arrestuarve u liruan për mungesë provash dhe akuzave të pabaza. Një pjesë e vogël personash dolën para gjyqit. Nga të dhënat dokumentare, rezulton se ndaj të arrestuarve në këtë periudhë, jo vetëm në Shkodër, por në të gjithë vendin, janë dhënë dënime arbitrare.

*“Dënimi nuk ekzekutohej nga gjyqi në bazë të procesit, por nga ne Nesti [Kerenxhi], (kur mungonte ky unë [Vaskë Koleci]), kishte lidhje të rregullta me gjykatat ushtarake dhe për çdo dënim kërkoheshë fjala e Sigurimit dhe kjo vendoste”.*³⁷

Këtë valë arrestimesh e pohon vetë drejtori i Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit, Koçi Xoxe duke thënë se, viti 1945-1946 ishte një etapë e parë e *“pastrimit dhe të konsolidimit të pozitive të pushtetit popullor, në të cilën mund të bëheshin edhe shkelle të ligjeve dhe efektivisht në këtë periudhë janë bërë më të shumta. Mbas periudhës së parë do të vinte një periudhë tjetër normale në të cilën nuk duhet të bëheshin lëshime e shkelle ligjesh”.*³⁸

3. Operacionet ndëshkuese në veriun e Shqipërisë

Në vitin 1945-1946, regjimi komunist përmes Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit dhe Divizionit të Mbrojtjes së Popullit³⁹ dhe forcave të tjera të ushtrisë, ndërmorën një sërë operacionesh ndëshkuese në Veriun e Shqipërisë në të cilat nuk munguan pushkatimet, çarmatimi i popullsisë, arrestimet e kundërshtarëve të regjimit, si dhe djege shtëpish.

Veriu, duke qenë qendra kryesore e rezistencës antikomuniste, përkrahës të Zogut, Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit, akoma nuk i qe nënshtruar forcave partizane. Veriu nuk i shpëtoi valës së represionit dhe operacioneve të ndërmarra nga pushteti i kohës, duke bërë arrestime të shumta pa material hetimor, duke zbatuar urdhërat arbitrare të Koçi Xoxes.

“Ishin lista të gjata emërore ku përmbi ose anash emrit shënohej gërma P (pushkatim) dhe T (torturim). Sipas këtyre shenjave konevcionale vartësit e tij kanë

³⁶ Po aty, fl. 19-21.

³⁷ AQSH, F. 411/Ap, V. 1949, D. 6, fl. 77. Promemorie mbi punën trockiste të organeve të Sigurimit të Shtetit.

³⁸ AQSH, F. 411/Ap, V. 1949, D. 1, fl. 125/1. Pjesë nga deponimi i Koçi Xoxes në Komisionin hetues, Tiranë, më 24 mars 1949.

³⁹ Shih: Florin Zyberaj, *Dokumente mbi Divizionin e Mbrojtjes së Popullit 1944-1946*, Vëll. I (Tiranë: ISKK, 2022).

vepruar”⁴⁰.

Operacionet ndëshkuese u zhvilluan edhe në Shqipërinë e Mesme, por kryesisht përqëndrimi ka qenë në Veri.

Ndër betejat më të ashpra në veri ishte ajo e Tamarës, më 14 janar 1945 dhe betejat e ashpëra në sektorët Bardhaj-Selcë dhe Rehovicë-Brojë më 16 dhe 17 janar 1945, të cilat përbëjnë një luftë frontale civile mes shqiptarësh, me përmasa të mëdha dhe pasoja tragjike, me shumë të vrarë e të plagosur, sidomos nga ana e Brigadës I dhe XXIV të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Sipas studiuesit Uran Butka, nuk kishte ndodhur në historinë e Luftës Nacionalçlirimtare që të ziheshin kaq shumë robër partizanë (nga batalioni IV i Brigadës XXIV - 15 robër lufte, ndërsa nga batalioni I i Brigadës I, 14 robër të tjerë).⁴¹

Përplasjet mes forcave partizane dhe atyre antikomuniste do të vazhdojnë gjatë gjithë vitit 1945. Forcat e ushtrisë partizane, vërshuan në veriun e Shqipërisë me objektiv parësor: marrjen e plotë nën kontroll të të gjithë territorit, si dhe eliminimin fizik të kundërshtarëve politik. Ndërkohë *“krerët e malësisë, Llesh Marashi, Pjetër Gjoka, Luket Marashi e të tjerë kishin filluar takime dhe diskutimet mes tyre për një mobilizim të përgjithshëm kundër forcave partizane në Shkrelë dhe Kastrat”*.⁴²

Në një relacion të Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit bëhet e ditur se më 23 janar u bë një kryengritje në Koplik nga të arratisurit e Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit në bashkëpunim me krerët e Malësisë së Madhe dhe bajraktarëve në qarkun e Shkodrës. Më 23 janar 1945, të arratisurit në bashkëpunim me popullin e katundit Kastrat, grumbulluan mbi 200 persona dhe *“vendosën të sulmonin Komandën e vendit Kastratë dhe Koplikun këtu ish qendra e Brigadës të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe me të filluar nga veprimi mendonin që Ranxa e Postriba do të rjeshtoheshin përkrah kryengritsave”*.⁴³

Në këtë datë u sulmua Kopliku në tri drejtime. Marshuan në Çezmën e Koplikut dhe aty u vunë në lidhje me Ranxat si me Tar Muslimin dhe në Grishje e Rrjoll me forcat e Jup Kazazit [përfaqësues i Ballit Kombëtar] dhe priteshin të vinin forcat e Shkrelit dhe Kastratit. Pas përplasjes me forcat partizane, përpjekja u zbeh dhe forcat e rebelëve u shpërndanë dhe do mblidheshin në Hot për një organizim tjetër. Pjesëmarrësit kryesorë në këtë kryengritje ishin: Llesh Marashi, Gjon Martin Luli dhe Mirod Paloka dhe të arratisurit Gjelo Sh Luli, Mark Leku, Nikoll Zefi, Mark

⁴⁰ AQSH, F. 411/Ap, V. 1949, D. 1, fl. 60. Pjesë nga deponimi i Koçi Xoxes, Tiranë, më 1949; Ana Lalaj, *“Pushteti dhe ‘tjetri’ që është përballë (Montimi i regjimit komunist në Shqipëri, 1944-1954)”* në: Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri në 1945-1990 (Tiranë: Albtipografia, 2019), 122.

⁴¹ Uran Butka, *Kryengritjet e para kundërkomuniste* (Tiranë: ISKK, 2013), 71.

⁴² Butka, *Kryengritjet e para kundërkomuniste*, 76-80.

⁴³ AMB, F. 59, V. 1945, D. 2, fl. 8. Relacion mbi kryengritjen e Koplikut, më 23 Kallnuer 1945.

Doshi, Nikoll Naci nga Hoti. Gjon Martini, Nik Gjeloshi nga Kastrati. Pjetër Gjoka nga Shkreli. Qëllimi kryesor ishte marrja e Shkodrës dhe organizimi i forcave ushtarake dhe shpresonin për ndërhyrjen e anglezve.⁴⁴

Më 12 shkurt 1945 komandanti i operacionit, Mehmet Shehu dha urdhër për zhvillimin e një operacioni të gjerë për kryerjen e aksioneve në Koplik, Dukagjin, Shkodër, si dhe të bëhej çarmatimi i popullatës me çdo kusht. Ai nënvizonte faktin se *“Reaksioni duhet asgjësuar. Populli duhet organizuar e mobilizuar. Kujt t’i kërkohet arma të dorëzojë armën ose shpirtin”*.⁴⁵

Në lidhje me operacionet ndëshkuese, Zoi Themeli, shefi i Seksionit të Mbrojtjes së Popullit, Krahina III, në një radiogram e njoftonte Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit se:

“Më 18/II/1945 në mëngjes shkova në Shënpal ku operonte Divizioni VIII dhe ka pushkatuar tetë vetë dezertorë dy prej këtyre kanë kundërshtuar me armë dhe nuk kanë dashur të dorëzohen këta janë Ndue Nikolli prej Viku dhe Llesh Pjetri prej Kashnjeti (Komuna Kalivac). Stop. Janë djegur 12 shtëpi kriminelësh dhe strehuesve të tyre stop. Janë dorëzuar tre veta t’aratisur dhe 18 ushtar dezertorë stop. Janë marë 167 armë të gjata dhe 20 revolvera, një mortaje e lehtë dhe një mitraloz i rëndë stop. Janë arrestuar tetë vetë midis tyre Pjetër Llesh Bajraktari stop. Më 19-20/II/1945 janë pushkatuar dy veta në katundin Domgjon të cilët kishin fshehur armët e katundit dhe mbas pushkatimit të tyre u muar 70 armë. Stop. U pushkatua Gjon Bdre Cani në katundin Perlat, strehues i Marka Carës stop. Në Dibrit janë marë 240 pushkë dhe 15 revolvera dhe janë mobilizuar 119 partizanë. Stop. Në Prelat janë marë më tepër se 100 pushkë dhe 20 revolvera. Stop”⁴⁶

Operacionet ndëshkuese përfshinë edhe rajonin e Kelmendit. Sipas një raporti të Zoi Themelit, dërguar Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit, më 27 shkurt 1945 thuhej se, “...humbjet armike janë 44 të vrarë e 21 të plagosun. Prej të vramëve rezultojnë të vramë gjatë përpjekjeve që kanë ba me forcat t’ona, po ashtu edhe të plagosurit e tjerë (6) janë të gjetur të ngrirë në Malin mbi Selc, 7 veta janë vrarë qysh me hyrjen e forcave t’ona në Kelmend të zënë në befasi duke bërë roje për me ndalue hymjen e forcave t’ona. 18 të tjerë janë ekzekutue prej forcave t’ona gjatë operacionit pse kanë mobilizue popullin në luftë kundër nesh [...]. Më tej në raport thuhet se, - gjatë operacionit ishin vrarë rreth 18 persona. Gjatë zhvillimit të këtij operacioni ishin djegur edhe 34 shtëpi. Në katundin Vermosh ishte djegur shtëpia e Fran Pali, Gjek Marashi, Lek Marashi, Rrok Lek Ujka, Gjergj Lula, Zef Kol Luci, Ndue Pjetër

⁴⁴ AMB, F. 59, V. 1945, D. 2, fl. 8. Relacion mbi kryengritjen e Koplikut, më 23 Kallnuer 1945.

⁴⁵ Zyberaj, *Dokumente mbi Divizionin e Mbrojtjes së Popullit 1944-1946*, 114. Dokumenti nr. 20.

⁴⁶ AMB, F. 59, V. 1945, D. 2, fl. 3. Radiogram i Zoi Themelit, dërguar Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit, Shkodër, më 21 shkurt 1945.

Marku, Ndue Marash Marku, Nikoll Gjergj Prengu dhe Marash Pali. Në katundin Nikël, u dogjën shtëpitë e Mark Marashi, Llesh Toma, Fran Zefi, Tom Dushi, Ded Nikolli, Nikoll Gjoka, Dem Sadrija. Në katundin Vukël shtëpitë e Kol Gjoni, Ded Gjoni, Fran Doçi, Zef Kola, Mirash Pali, Ndue Gjoni, Lek Marku, Gjergj Toma, Ndue Frani, Gjon Kola. Në katundin Rahovicë, shtëpitë e Mark Gjeloshit, Lum Miri, Caf Marashi, Tom Lula, Fran Zefi, Vat Mirashi, Gjon Gjeka. Krahas djegies së shtëpive, këtyre personave iu është sekuestruar e gjithë pasuria që ata dispononin. Në këtë operacion ishin internuar edhe 19 familje nga më reaksionarët”.⁴⁷

Në lidhje me reprezaljet dhe terrorin e ushtruar në raportin e sipërpërmendur thuhet se:

“Në kohën kuer forcat tona hynë në Kelmend, dhe që hynë atje, gjithë populli ishte largue, tuej marrë dhe fëmijët (djelmt) ç’prej 5-6 vjeç me vedi ndër shpella tuej kujtue se do t’i therin Partizanët ç’do njeri që është mashkull qoftë i vogël, qoftë i madh. Veç kësaj të gjithë vajzat që kishin mbetur nëpër shtëpi, që prej 15 vjet e lartë ishin veshur të gjitha nuse, e kështu paraqiteshin që mos t’i marrin Partizanët mbasi ishin vajza, siç ju kishin thënë, reaksionarë”.⁴⁸

Nga ky raport mësojmë se populli i Kelmendit nuk kishte një mendim të mirë mbi partizanët shqiptarë, madje kuptohet frika nga veprimet e tyre terrorizuese të bëra kryesisht ndaj kundërshtarëve politikë apo shënjestrimi i atyre që dyshoheshin se kishin bashkëpunuar me pushtuesin, si dhe nga frika e tyre ishin larguar duke u fshehur nëpër male dhe shpella.

Imazhi negativ në popull mbi partizanët sipas raportit të Zoi Themelit, vinte si rezultat se, - populli i Kelmendit ishte popull malësor, i prapambetur dhe analfabet dhe se reaksionarët [kundërshtarët politikë të lëvizjes NÇ - *shënimi im*] në bashkëpunim me klerin e kishin shfrytëzuar këtë gjendje duke hedhur parulla kundër tyre, duke u prishur imazhin partizanëve.⁴⁹ Më tej, në vazhdim të raportit, thuhej se populli ishte i tmerruar dhe se i kishte fajet se nuk e kishte kuptuar se ishin një ushtri e fortë dhe se nuk e kishin menduar ndonjëherë se forcat partizane do hynin në katundet e tyre. Sipas Z. Themelit, duhej *“biseduar me popullin se çfarë është pushteti popullor, dhe jo ai i paraqitur nga armiqtë e popullit dhe reaksionarët”*.⁵⁰

Reprezaljet e bëra nga partizanët prekën edhe zonën e Shalës, ku forcat e Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit kishin grumbulluar:

500 pushkë, 229 të mobilizuar, 12 të arrestuar, 3 shtëpi të djegura e 3 të pushkatuar. Në Shllak: 308 pushkë, 18 rovole, 80 të mobilizuar, 2 të arrestuar, 1 i pushkatuar dhe 6 shtëpi të djegura. Në Shoshë: 180 pushkë, 5 mitraloz, 13 rovole, 15 të mobilizuar,

⁴⁷ AMB, F. 59, V. 1945, D. 2, fl. 4-5. Raport operacional në rajonin e Kelmendit, Shkodër, më 27 shkurt 1945.

⁴⁸ Po aty, fl. 6. Raport operacional në rajonin e Kelmendit, Shkodër, më 27 shkurt 1945.

⁴⁹ Po aty, fl. 6.

⁵⁰ Po aty.

10 të arrestuar. Koplik-Kastrat-Shkrel: 252 të mobilizuar, 523 pushkë, 46 revole. Në Trushë: 100 pushkë, 2 të pushkatuar, 2 shtëpi të djegura, 15 të arrestuar, 30 të mobilizuar.⁵¹

Jo vetëm Shkodra, por edhe Mirdita përjetoi valën terrorizuese të formacioneve të pushtetit komunist. Në Mirditë thuhej se:

“Janë pushkatue 3 (tre) partizan dezertor, dy nga këta kishin kundërshtue kundra forcave t’ona, si dhe 13 të tjerë të cilët kishin qenë strehuesit e reaksionarve; njani nga këta kishte tentue të hikte nga burgu. Si rezultat i këtyre masave ka qenë: armë të mbledhuna 1667 dhe 102 revole, një mitraloz i randë e një mortaj e lehtë. Ishin mobilizue edhe 489 Partizan. Veç këtyre është edhe një numër deri në 16 t’arrestuar, por ato ala si kanë dërgue për Shkodër. Gjithashtu janë djegur edhe 30 shtëpi të strehuarve dhe të dizertorve. Këto masa të marruna në at rreth banë që populli të tronditet dhe në shumë katunde të dorëzojnë armët vetë”.⁵² “Forcat t’ona duke parakaluar bënë: çarmatimin, mobilizimin, organizimin. Operacioni vazhdon... Nikaj-Mërtur...duke avancuar për në Krasniqe e deri në kufi”.⁵³

Edhe në Lezhë forcat partizane kryen operacione, kryesisht në çarmatimin e popullsisë dhe hedhjen e parullave dhe demaskimin e kundërshtarëve të regjimit. “Në shkresën nr. 192/I; datë 30/III/1946, në krahinën e Lezhës u demaskuan qëndrimi i Baba Aliut në lidhje me kriminelët që populli e priti mirë. Kriminelët e kapur në atë krahinë që ndodhen në burgun e Tiranës të mos nxirren para gjyqit më asi kemi meju

⁵¹ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1944-1948*, Vëll. I, përgatiti: Sabit Syla & Qerim Lita (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2020), 81. Përgatitësit i referohen: *AJ. 507, IX, I/II-41, broj listova 4, datum 08. III. 1945.*

⁵² *AMB*, F. 59, V. 1945, D. 2, fl. 16. Raport mbi zonën e Mirditës. Bashkëngjitur këtij raporti është edhe lista e 16 personave të pushkatuar [Ndue Marku, Dod Preng Biba, Frrok Gjoka, Ndue Gjegie Pepa, Dod Lleshi, Llesh Nikoll Biba, Gjin Ndue Reçi, Losh Cubi, Mirak Mema, Llesh Pjetri, Ndue Nikolli, Gjon Ndre Cara, Preng Gjoni, Mark Ndue Cupi, Dod Llesh Tusha dhe Ndue Gjin Lleshi] si strehues, dezertor ose që nuk kishin pranuar të dorëzonin armët. Shtëpi të djegura ishin në total 30 [shtëpia e Pjetër Marka Ndoj, Nikoll Jake Nikolli, Pjetër Ndue Kola, Gjin Ndre Koçi, Llesh Cubi, Pal Nika, Gjon Dodani, Ndue Nikoll Perndreca, Pjetër Heneku, Preng Frrok Prenga, Kol Bib Lleshi, Gjergj Ndoj, Marka Gjoka, Pjetër Frrok Prenga, Marka Doda, Pjetër Alija, Nikoll Ndoj, Ndre Ndue Prenga, Gjon Gjet Vokri, Dod Biba, Ded Mark Kola, Llesh Shkurti, Shahin Doci, Must Vata, Kol Prenga, Kol Nikoll Kola, Ndue Llesh Lusha, Gjet Marka Nikolli, Marka Ndue Kola]. Shkaku i djegies së shtëpive të tyre vinte, pasi ata akuzoheshin si: dezertor, strehues, përkrahës të arratisurish, reaksionar, nuk dorëzonin armët. - *AMB*, F. 59, V. 1945, D. 2, fl. 17-18. Lista emërore e të pushkatuarve dhe shtëpive të djegura.

⁵³ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1944-1948*, Vëll. I, përgatiti: Sabit Syla & Qerim Lita (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2020), 81. Përgatitësit i referohen: *AJ. 507, IX, I/II-41, broj listova 4, datum 08. III. 1945.*

që parullat e lëshura nga Populli i Martaneshit kundra tyre".⁵⁴

- Viti 1946 u mbyll me shtypjen e një prej rezistencave më të mëdha antikomuniste të viteve të para të diktaturës, atë të Postribës. Informacionet për organizimin dhe mundësinë e shpërthimit të kësaj kryengritjeje në Shkodër ia dha shtetit shqiptar nga këshilltari jugosllav Mijat Vuletić, i cili kishte ndihmuar në organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit.⁵⁵ Drejtimi i parë, nga Postriba drejt kazermave të ushtrisë, ku ishte komanda e Korpusit III, si dhe kundër forcave të ruajtjes së burgut të madh, me qëllim lirim të burgosurve politikë;
- Drejtimi i dytë, nga Guri i Zi drejt postës së Urës së Kirit, si dhe;
- Drejtimi i tretë ishte drejt Kodrave të Tepes.⁵⁶

Menjëherë pas raportimit të këshilltarit jugosllav, M. Vuletić, udhëheqja komuniste pasi shqyrtoi raportin, urdhëroi ndërhyrjen ushtarake. Forcat e ushtrisë, të Divizionit të Mbrojtjes së Popullit dhe të Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit sulmuan pozicionet e kryengritësve duke bërë që kryengritësit të tërhiqeshin dhe lëvizja e tyre të dështonte. Rebelimi i tyre ndaj regjimit u shtyp në mënyrë të dhunshme. Ndaj popullatës dhe kryengritësve u morën masa ndëshkuese si pushkatime, tortura, djegie shtëpiash, ndjekje, arrestime dhe burgosje.

Vetëm në "*fishën e Shtojt u pushkatuan 12 burra pa gjyq*".⁵⁷ Pas shtypjes së kryengritjes, forcat partizane të Divizionit të Mbrojtjes së Popullit dhe të Drejtorisë të Sigurimit të Shtetit, dogjën 33 shtëpi, mbi 69 persona u arratisën, 200 persona u arrestuan, dhe 33 persona u pushkatuan, 5 persona u pushkatuan me gjyq.⁵⁸ U zhvilluan 5 procese të mëdha gjyqësore e disa të tjera më të vogla, dënime individuale, duke përfshirë edhe implikimet.⁵⁹

Shkaqet e dështimit të kryengritjes janë disa, por më kryesorët duhen vënë në dukje:

⁵⁴ AQSH, F. 14/AP-Str, V. 1946, D. 50, fl. 15. Telegram i Nasho Nathanailit për Koçi Xoxen, datë 5 prill 1946.

⁵⁵ **Sigurimi i Shtetit Shqiptar** është themeluar, më 10 dhjetor 1944. Në vitet e para njihet me emërtesën: Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit dhe ishte nën varësinë e Ministrisë së Luftës dhe Mbrojtjes Kombëtare me në krye Enver Hoxhën. Pas muajit mars të vitit 1946 iu ndryshua emërtesa dhe u quajt Drejtoria e Sigurimit të Shtetit dhe kaloi nën varësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

⁵⁶ Uran Butka, *Ringjallje* (Tiranë: Phoenix, 1995), 136; Demir Dyrmishi, *Aktivizimi i kundërshtarëve politikë dhe kryengritja e Postribës (janar-shtator 1946)* në: *Studime historike*, V. LIII (XXXVI), nr. 1-2 (Tiranë: Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të RSH, 1999), 120.

⁵⁷ Eljaz Bushaj, *Një vështrim rreth kryengritjes së Postribës: 9 shtator 1946* (Tiranë: Emal, 2011), 31.

⁵⁸ AMB, F. 8, V. 1946, D. 62, fl. 12-30.

⁵⁹ Shih gjerësisht: AMB, F. 1, D. 1083-A (1). Dosja gjyqësore e grupit të Kryengritjes së Postribës, Shkodër; AMB, F. 1, D. 1083-A (2).

- Moskoordinimi mbi sulmin që do kryhej;
- Mungesa e mobilizimit;
- Kryengritësit nuk arritën të siguronin mbështetje nga jashtë;
- Epërsia e forcave komuniste në armatime dhe numër, kundrejt kryengritësve etj.

Át Zef Pllumi në veprën e tij *“Rrno vetëm për me tregue”*, mbi hyrjen e forcave komuniste në Postribë dhe shtypjen e kryengritësve e kujton me këto fjalë:

“Vetë 9 Shtatori i 1946 kje një ditë e zezë për mbarë Postribën. Ata djelmët e strehuem e të mbajtur në shplak të dorës prej tyre, të cilët pothuaj ende ishin tue pertypë bukën bujare të postribasve, ata, tashti oficera të Sigurimit të Shtetit, u prinë bataljoneve ndëshkuese dhe hynë në Postribë tue vra e pushkatue sa u desh zemra e keqe. E vërtetë që nuk vepruen si Mehmet Shehu në Kelmend, por edhe këta pa kurrfarë mëshire i lidhën burrat e Postribës dhe krijuen në Shkodër burgje të reja për ta, mbasi burgjet që ishin deri atëherë nuk kishin si me i nxanë... edhe të gjitha katundet e tjera, si Rragam e Gur i Zi, Ana e Malit, Berdicë, Bushat, Beltojë, Trush e Barbullush nuk mujtën me u shpëtue veprimeve ndëshkimore të qeverisë, që t’i kapi e t’i shtrojë në hû pa mëshirë të gjithë ata burra të shtëpiave ku ishin mâ në namë e në zâ. Ndërkaq në qytetin e Shkodrës terrori nuk bani mâ dallim nëse je katolik o musliman, por u rrasën nëpër burgje së pari “shpijat e mdha” mandej të gjithë intelektualët, tue përfshí edhe të gjithë studentat universitarë jashtë shtetit”.⁶⁰

Si përfundim mund të themi se: kryengritësit e Postribës thurën plane dhe organizuan kryengritjen duke shfrytëzuar: *Së pari*, gjendjen jo të mirë në arenën ndërkombëtare të qeverisë provizore shqiptare. Regjimi komunist kishte përplasje me SHBA-në dhe Britaninë e Madhe, përplasje që lidhen me misionet ushtarake, si dhe me konfliktin e 15 maj 1946 në incidentin e Kanalit të Korfuzit kur “dy kryqëzorët britanikë [Orion dhe Senpent], që gjendeshin në ujërat territoriale shqiptarë, u goditën nga rojat e baterive bregdetare shqiptare, por pa u shkaktuar dëme”.⁶¹

Së dyti, shfrytëzuan mungesën e ftesës së Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris, më 1946. Në këtë konferencë, Shqipëria kërkoi që të merrte pjesë, të njihej si pjesë e koalicionit antifashist dhe të trajtohej si palë e barabartë dhe të merrte dëmshpërblime nga dëmet e shkaktuar nga lufta.

Pavarësisht shtypjes, “kryengritja e Postribës tregoi mjaft qartë se, kundërshtarët politikë nuk pajtoheshin me doktrinën komuniste dhe sistemin diktatorial që po instaloheshin dita ditës, dhe se do vazhdonin qëndresën e tyre me të gjitha mjetet deri

⁶⁰ Át Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue* (I), Libri i kujtimeve: pjesa e parë 1944-1951, Botimi V (Shkodër: Botime Françeskane, 2020), 86-87.

⁶¹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX (1945-1999)*, Vëll. V (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2023), 242.

në vetëflijim”.⁶² Ata synonin përmbysjen e regjimit komunist dhe vendosjen e rendit liberal.

4. Arratisja e kundërshtarëve dhe grupet antikomuniste brenda vendit

Trysnia e ushtruar, si dhe frika nga përndjekja, në prag të marrjes së pushtetit nga Partia Komuniste e Shqipërisë bëri që shumë kundërshtarë politikë të tyre, të linin vendin dhe të emigronin. Nga ana e regjimit të ri [komunist], bazuar në përkufizimin që jepet në dokumentet e kohës, konsideroheshin “*të arratisur politikë të gjithë ata funksionarë, të vegjël e të mëdhenj, persona të ndryshëm që kanë qenë në shërbim të okupatorit (ballista e njerëz të legalitetit) të cilët ndodhen të arratisur mbrenda ose jashtë Shqipërisë*”.⁶³

Në fakt, akoma pa hyrë qeveria provizore në Tiranë, më 28 nëntor 1944, shumë shqiptarë, kryesisht përkrahës dhe anëtarë të Ballit Kombëtar, Legalitetit, nacionalistë, intelektual etj, por edhe individë të caktuar të cilët nuk mbështesnin asnjë forcë politike në Shqipëri, për shkak të situatës së krijuar nga lufta civile, si dhe frikës nga përndjekja e tyre, u detyruan të lënë Shqipërinë dhe të arratisen. “*Në vitin 1944 u arratisën nga Shqipëria 1627 persona dhe në vitin 1945, lanë vendin 787 persona*”.⁶⁴ Të arratisurit u strehuan kryesisht në Itali, Greqi, Francë, Austri, Gjermani etj. Nga qeveria komuniste, ata u quajtën “Kriminelë lufte”, “Armiq të popullit”, si dhe iu vendosën etiketime nga më të ndryshme.

Duhet theksuar se, ata që Partia Komuniste Shqiptare i konsideronte armiq të popullit, në fakt ishin armiq të pushtetit të saj. Në vitin 1945, Shqipëria i bëri edhe një kërkesë OKB-së për t’i dorëzuar të ashtuquajturit “Kriminelë lufte”, kërkesë kjo e cila nuk u pranua. Më poshtë është dhënë një statistikë mbi të arratisurit jashtë shtetit në vitet 1944-1946, sipas rretheve.

Tabela nr. 1. Statistikë mbi të arratisurit jashtë shteti 1944-1946.

Rrethi	1944	1945	1946	Shuma
Gjirokastrë	499	438	169	1.106
Sarandë	322	217	102	641
Tepelenë	39	4	8	51

⁶² Dyrmishi, *Aktivizimi i kundërshtarëve politikë dhe kryengritja e Postribës (janar-shtator 1946)*, 121.

⁶³ *ASHV/Dibër*, F. 1, V. 1945, D. 4, fl. 26.

⁶⁴ *AMB*, F. 4/dega e bandave, V. 1962, D. 166, fl. 1-2.

Përmet	99	11	4	114
Vlorë	280	32	38	350
Fier	42	5	5	52
Berat	9	-	4	13
Skrapar	8	-	6	14
Korçë	56	24	21	101
Ersekë	25	22	33	80
Pogradec	7	5	6	18
Elbasan	14	2	1	17
Librazhd	7	-	-	7
Gramsh	8	-	2	10
Lushnje	12	1	3	16
Durrës	38	1	6	45
Tiranë	44	1	3	48
Krujë	10	1	-	11
Mirditë	6	-	7	13
Mat	31	2	1	34
Shkodër	37	2	8	47
Lezhë	3	-	-	3
Pukë	4	2	3	9
Kukës	10	4	2	16
Peshkopi	11	11	14	36
Tropojë	6	2	-	8
Shuma	1627	787	446	2.860

Burimi: AMB, F. 4/dega e bandave, V. 1962, D. 166, fl. 1-2.

Problemi i pushtetit në Shqipëri sipas studiuesit Gjon Boriçi, ishte një ndër gjërat që shqetësonte më shumë Enver Hoxhën. Sipas tij, “*përveç informacioneve lidhur me krijimin e partive shqiptare jashtë vendit, udhëheqësin komunist shqiptar e shqetësonte edhe deklarata e Mehmet Konicës raportuar Hoxhës nga Drejtoria e Mbrotjes së Popullit seksioni i parë mbi të arratisurit shqiptar*”.⁶⁵ Të arratisurit, si në Itali ashtu edhe në Francë kishin filluar të organizoheshin, njëkohësisht sulmonin Frontin Nacionalçlirimtar, dhe kjo gjë e kishte shqetësuar së tepërmi Enver Hoxhën. Për të kontrolluar aktivitetin politik të të arratisurve, regjimi i ri

⁶⁵ Gjon Boriçi, “*Përpyjekjet e sigurimit të shtetit për të vënë nën kontroll emigracionin politik shqiptar në vitet 1945-1974*”, në: Emigracioni politik shqiptar në vitet 1944-1990 (Tiranë: Onufri, 2021), 111-113.

angazhoi forcat e Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit.

Shqetësim për udhëheqjen komuniste nuk ishte vetëm emigracioni i jashtëm dhe aktiviteti i tyre, por edhe aktiviteti i kundërshtarëve të pushtetit komunist që qëndruan në vend, të cilët zhvillonin veprimtarinë e tyre në ilegalitet. Për minimizimin e aktivitetit të tyre, ndjekjen, survejimin, deri në eliminimin fizik të kundërshtarëve të pushtetit të ri, u përfshinë tri organe të diktaturës: (1) Njësitë dhe forcat e Ushtrisë; (2) Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit (në vitin 1946, njihet me emërtesën Drejtoria e Sigurimit të Shtetit); (3) Divizioni i Mbrojtjes së Popullit. Të tria këto institucione në bashkëpunim me njëra-tjetrën ndërmorën një sërë operacionesh që si qëllim kishin minimizimin e veprimtarisë së kundërshtarëve politikë të PKSH-së deri në asgjësimin e tyre.

Në një raport të Seksionit II të Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit nënvizohej fakti se: "...kishin listat e t'aratisurve, përbërjen e tyre, armatimin, zonat ku vërtiten, bazat, miqt e furnizuesit e tyre. Por një pjesë t'aratisurve kemi shënime të shkurtëra rreth biografisë së tyre. Gjatë kësaj kohe janë bërë goditje të vazhdueshme kundër t'aratisurve. Duke u-mbështetur n'informatat e Seksioneve dhe në bashkëpunim me forcat e mbrojtjes në çdo qark, e sidomos në Shqipërinë e Mesme e të Veriut janë organizuar ndjekje të gjëra, operime lokale legale e ilegale dhe goditje të vogla".⁶⁶

Në një raport tjetër, dërguar Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare nga Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit në mars të vitit 1945 përmenden disa grupe antikomuniste të armatosura që vepronin brenda vendit, si:

"...I) Llesh Marashi me 5-6 veta vërtitet në rethet e Shkrelit. II) Jup Kazazi organizator i reaksionit dhe përhapës i parullave t'organizuara n'at krahinë sidomos në rethet e Shkodrës sillet në Gruemirë, Grizhë e Vukatanë me 3-4 veta dhe herë me më tepër. Ky bën lëvizje të shpeshta e të largta. III) Fiqiri Dine - Hysni Dema këta vërtiten në rethet e Peshkopisë në zonat Maqellare, Sllovë e nuk bëjnë lëvizje. IV) Marka Gjon Marku me Pjetër Kleshin vërtiten në komunën e Kulivaçit, Mnellë etj. V) Prenk Previzi vërtitet në Skuraj, Mali Bardhë, Kurbin e Bregu i Matit. Për këtë thuhet se ka lidhje me reaksionin ndërkombëtar dhe se këto lidhje i mban hala me anë të një nëndetse. Parullat i lëshon shumë të freskta dhe t'organizuara. VI) Llesh Gjon Marku (biri i M. Gj. M.) me Ndue Bajraktarin vërtiten në komunën e Dibrit. VII) Muharrem Bajraktari ky vërtitet në rethet e Lumës në Ujmisht, Sllovë, Reç e Dardhë. Ndihmohet indirekt prej Cen Elezit si mik. VIII) Patër Anton Arapi për këtë thuhet se ka qenë me Lef Nosin në Malsi të Shkrelit ka me vehte 6-7 veta, 4-6 mitralozë, 2 automatikë. IX) Pashuk Mirakaj me një grup 10-12 veta vërtitet në rethet e Pukës. X) Kolë Bib Mirakaj tash është ndier të lëvizë në zonën e Dukagjinit. XI) Gjon Dodani udhëheq një grup 10-12 veta: ky ka qenë toger milicije. XII)

⁶⁶ AMB, F. 4/shtabi, V. 1946, D. 6, fl. 5. Pjesë nga raporti mbi punën e Seksionit II të Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit (dhjetor 1944 - mars 1946): III/Të arratisurit.

Gjelosh Luli Ky ka marë pjesë në sulmin mbi Koplik thuhet se qëndron në Hot e Grudë pse siç thuhet i kanë ngrirë këmbët”.⁶⁷

Familja Kazazi, si përkrahëse e Ballit Kombëtar konsiderohej shumë e rrezikshme nga ana e regjimit të ri. Për të kapur Jup Kazazin⁶⁸ disa herë ishin ndërmarrë veprime operacionale. Divizioni i Mbrojtjes së Popullit njoftonte Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit se: “n’orën 5 të mënjazit 13 Qershor 45 dy Skuadra të Kompanisë Shtabit Brigadës II-të ranë në përpjekje me kriminelin Jup Kazazin, Zenel Kazazin dhe Hamit Kazazin, përpjekja u bë por pa u kompletuar mirë rrethimi, kështu që u zu vetëm Hamit Kazazi dy të tjerët kanë hik pa armë. Jupi është plagosur, shokët vazhdojnë ndjekjen”.⁶⁹ Në një telegram të Zoi Themelit, dërguar Nesti Kerenxhit i shpreh këtij të fundit se, më 16 shtator 1946, pasi u zbulua se ku qëndron i fshehur J. Kazazi do bëhej rrethimi i tij. Më 17 shtator 1946, shtëpia e Rifat Koplikut u rrethua nga forcat e shumta të Drejtorisë të Mbrojtjes me në krye, Zoi Themelin së bashku me vartësit e tij, Sirri Çarçani, Dul Rrjolli dhe Dulaq Lekeqin. I gjendur përballë rrethimit dhe izolimit, si dhe për të mos iu dorëzuar forcave të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit, ai vrau veten. “Zoi Themeli për këtë ngjarje shprehej se, “këtu popullarizohet se e vramë ne”.⁷⁰ Nga ana e Seksioneve të Mbrojtjes së Popullit kishte filluar ndjekja e grupeve antikomuniste. Seksioni i Mbrojtjes së Popullit, Durrës njoftonte Divizionin e Mbrojtjes së Popullit se: “...Këto ditët e fundit kemi diktuar edhe mbledhje reaksionare që bëhen këtu në qytet nga elementa reaksionare, në grupe 7-8 vetësh, njërin nga të cilët grupe e udhëhiqen nga Ibrahim Loca, por

⁶⁷ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1944-1948*, Vëll. I, përgatiti: Sabit Syla & Qerim Lita (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2020), 83. Raport nga Drejtoria e Mbrojtjes së Popullore, dërguar Ministrisë së Mbrojtjes në Tiranë mbi situatën e përgjithshme politike e të sigurisë në krahinat veriore, Tiranë, më 8 mars 1945. Përgatitësit i referohen: *AJ. 507, IX, I/II-41, broj listova 4, datum 08. III. 1945. Shënim:* Fiqiri Dine u arratis për në Greqi, nëpërmjet Maqedonisë, shtator 1946, po ashtu edhe Muharrem Bajraktari u arratis në Greqi në shtator të vitit 1946, ndërsa Patër Anton Hrapit u dënua me vdekje më 12 shkurt 1946 nga Gjykata Ushtarake e Tiranës.

⁶⁸ Me formimin e organizatës “Balli Kombëtar”, Jup Kazazi ishte veprimtar i B. Kombëtar në zonën e Shkodrës. Në këtë organizatë kishte vendin e “anëtarit krahinor” si dhe ishte i ngarkuari kryesor për ngritjen e çetave në veri. J. Kazazi ishte, gjithashtu, udhëheqës ushtarak i Ballit Kombëtar dhe organizator i Luftës së Reçit. Me ardhjen në pushtet të komunistëve, ai do vihej në ndjekje të vazhdueshme nga forcat e Divizionit të Mbrojtjes së Popullit në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit.

⁶⁹ *AMB*, F. 140, Pa vit, D. 211-A, fl. 104. Njoftim i shtabit të Divizionit të Mbrojtjes së Popullit për Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit mbi operacionin e ndjekjes së Jup Kazazit, Tiranë, më 14 qershor 1945. *Shënim:* Hamit Kazazi u kap dhe u arrestua nga forcat ushtarake të Divizionit të Mbrojtjes së Popullit më 21 mars 1945, ndërsa Zeneli u plagos dhe u arrestua po nga këta forca në qershor të vitit 1946.

⁷⁰ *Po aty*, fl. 2-3, 9.

*jemi në bashkëpunim me S.M.P.-in e Durrësin për t'i kapur në fakte konkrete. Në popull nuk është besimi si duhet kundrejt qeverisë s'onë të cilën e quajmë si një tranzicion të kohës”.*⁷¹ Survejimi dhe ndjekja vazhdoi intensivisht edhe për grupet e Sabri Begut nga Maqellara, Muharrem Bajraktari (Lumë), Sul Kurtit (Mati), Fiqiri Dine, Hysni Dema, Dan Kaloshi (Dibër).

Në Shqipëri, krahas grupeve të sipërpërmendura kemi edhe grupe të tjera antikomuniste, ku ndër to mund të përmendim: grupin e Ibrahim Locës, Bilal Kolës, Sul Kurtit, Ndec Lufaj, Gjon Mark Gjonin, Cen Elezit, Tahir Mema, Llesh Gjok Markaj, Llesh Bajraktari, Bardhok Mark Gjoka, Mark Bib Vokrri, Mark Ded Gjini, Frok Mylyshi, Ndue Bajraktari, Mark Gegë Cara, Gjon Mëhilli, Ymer Keqit, Xhemal Gjokës, Baft Qepalit, Adem Maneakut, Ram Habilit, Hajdar Shahinit.

Divizioni i Mbrojtjes së Popullit kishte identifikuar që në vitin 1945 emrat e personave përkrahës të grupeve: Ymer Keqit, Xhemal Gjokës, Baft Qepalit, Adem Maneakut, Ram Habilit e Hajdar Shahinit dhe ndërmori operacione në ndjekjen e tyre gjatë vitit 1946. Në këtë periudhë u ndoqën edhe krerët e tjerë të grupeve antikomuniste. Këtu mund të përmendim rastin e Cen Elezit, i cili më 28 mars 1946 u detyrua të arratiset nga shtëpia së bashku me bijtë e tij. Pas katër muajsh, bijtë e Cen Elezit iu dorëzuan autoriteteve shtetërore të cilët i burgosën. Vetë Cen Elezi arriti të arratiset jashtë vendit, shkoi në Maqedoni, por u kap nga autoritetet shtetërore të asaj kohe dhe u burgos.⁷²

Bilal Kola, i cili zhvilloi veprimtarinë e tij në ilegalitet kundër regjimit në zonën e Matit, së bashku me Ndrec Lufaj ishin në ndjekje të vazhdueshme nga forcat e ndjekjes së Divizionit të Mbrojtjes së Popullit. Kola tentoi të arratiset për në Jugosllavi, por gjatë kalimit të kufirit u vra më dhjetor të vitit 1948.⁷³ “*Mark Gegë Cara u vra më 30 shtator 1948; Mark Bib Vokrri u vra më 30 tetor 1948, ndërsa Bardhok Mark Gjoka më 30 gusht 1948*”.⁷⁴

Drejtorja e Mbrojtjes së Popullit në bashkëpunim me Divizionin e Mbrojtjes së Popullit ndërmorën operacione për të kapur edhe individë të arratisur si për shembull: Alush Lleshanaku (Elbasan), Xhevdet Blloshmi (Bërzeshtë). Për këto dy persona, Drejtorja e Mbrojtjes së Popullit shkëmbente vazhdimisht shkresa me Seksionet e Mbrojtjes. Në një shkresë të Seksionit të Mbrojtjes së Popullit Elbasan për Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit thuhej: “na njoftoni se ç’dijeni keni rreth Alush Lleshanakut nga Elbasani, mbasi informohemi se Alushi ndodhet prej katër

⁷¹ Zyberaj, *Dokumente mbi Divizionin e Mbrojtjes së Popullit 1944-1946*, 223.

⁷² Zyberaj, *Dokumente mbi Divizionin e Mbrojtjes së Popullit 1944-1946*, 142-143.

⁷³ Zyberaj, *Dokumente mbi Divizionin e Mbrojtjes së Popullit 1944-1946*, 208.

⁷⁴ *Shih*: Arkivi i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (më tej: AISKK), Fondi (më tej: F). 1, Dosja (më tej: D). Dosja e enciklopedisë së viktimave të terrorit komunist.

mujësh në Elbasan si i arratisun”.⁷⁵

Ndërsa në një njoftim nga nënseksioni i Mbrojtjes së Popullit, Librazhd për Komandën e rrethit Librazhd, për Xhevdet Blloshmin thuhej se: *“Për të diktue gjurmën e Xhevdet Blloshmit dhe të Qerim Zagollit të dyj t’arratisur nga katundi Bërzeshhtë, dhe mbasi dyshojmë të qëndrojnë të mëshefur në këto shtëpija që po ju shënojmë në listën e bashkëngjitur”⁷⁶, tu bëhet kontroll i mirë shtëpijave, ndër të cilat një pjesë bajnë pjesë edhe në këshillat e katundeve, por këtyne tu kallzohet se po u kontrollojmë për sy të popullimit, n’anë tjetër të kontrollohen imët se janë të dyshimt...”⁷⁷.*

Nga dokumentet e Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit, Seksioni II, jepen të dhëna mjaft interesante për numrin e personave të arrestuar, të kundërshtarve të regjimit të quajtur “kriminelë lufte” nga nëntori 1944 deri në shkurt 1946. Gjithashtu, sipas prefekturave jepet dhe numri i personave të arrestuar që kanë strehuar të gjithë personat kundër regjimit dhe kanë furnizuar me armë, me ushqim apo me veshmbathje të arratisurit për motive politike. Më poshtë jepen dy statistika.

Tabela nr. 2. Të arrestuar si “Kriminelë lufte”

<u>PREFEKTURA</u>	Nëntor 1944	Janar	Fruer	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korik	Gusht	Shtat	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Fruer 1946	Shuma për çdo prefekturë
KUKËSI	-	-	8	11	7	4	5	4	2	-	3	8	-	4	3	59
GJINOKASTRA	140	50	60	40	60	42	35	23	22	13	30	23	8	10	4	560

⁷⁵ AMB, F. 140, D. 1760 (Materiale të bandës së A. Lleshanakut, Vëllimi VI), fl. 121. Kërkesë nga Seksioni i Mbrojtjes së Popullit, prefektura e Elbasanit për Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit Tiranë, Elbasan, më 13 nëntor 1945. Alush Lleshanaku në dhjetor të vitit 1946 arratiset dhe shkoë në Greqi. Në 1949-ën zbriti me parashutë në Mirditë, për të riorganizuar forcat nacionaliste, që vepronin në malet e Shqipërisë së Veriut. Bashkë me Xhevdet Blloshmin, përshkoi në fshetësi zonat më të thella, që nga Veriu i Shqipërisë deri në zonën e Elbasanit, ku vepronin rregullisht çetat nacionaliste. U vra nga forcat e Sigurimit të Shtetit në vitin 1950.

⁷⁶ Shtëpitë që do të kontrolloheshin nga forcat e postkomandës së Quksit, ishin këto: shtëpia e Rifat Lekës, Isuf Mersini, Kadri Prifti, Hoxhë Ibrahim Çekrezit, Rakip Vretoja, Shaban Vretoja, Shahin Çekrezi, Murat Blloshmi, Rustem Pjetri, Isuf Blloshmi, Arif Verto, Ram Pecaku, Jaçe, Çekrezi, Hysen Meta, Sul Mrija.

⁷⁷ AMB, F. 1, D. 225/5 (fashikull), Vol. I, fl. 49. Njoftim i nënseksionit të Mbrojtjes së Popullit Librazhd për Komandën e rrethit M. P Librazhd, më 18 maj 1946.

Legjislacioni dhe mjetet e dhunës së pushtetit në Shqipërinë e pasluftës 1944-1946

SHKODRA	40	322	301	142	77	36	73	68	22	21	14	-	13	1	4	1134
KORÇA	179	60	40	26	44	67	32	40	26	40	26	18	16	6	7	627
ELBASANI	22	32	36	50	29	12	32	4	4	2	2	-	2	2	16	245
VLORA	65	80	75	56	37	23	69	39	17	4	3	1	3	5	36	513
BERATI	57	31	23	17	16	30	8	10	-	7	15	-	1	1	1	217
PESHKOPIJA	3	7	2	20	5	8	45	30	20	6	5	1	9	3	-	173
DURRËSI	48	30	31	20	10	14	17	7	10	12	8	23	12	30	45	317
TIRANA	354	81	74	24	42	20	21	16	10	6	9	1	2	-	-	660
Shuma e përmuajshme	908	693	650	406	327	256	337	241	142	111	115	75	66	62	116	4.505

Burimi: AMB, F. 4/shtabi, V. 1946, D. 6, fl. 11.

Tabela nr. 3. *Të arrestuar si “Strehusa dhe furnizusa të arratisurish”*

PREFEKTURA	Nëntor 1944	Janar	Fruer	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korik	Gusht	Shtat	Tetor	Nëndor	Dhjetor	Janar	Fruer 1946	Shuma për çdo prefekturë
KUKËSI	41	-	1	8	10	2	9	1	3	-	-	-	-	2	2	79
GJINOKASTRA	1	-	-	1	2	-	2	1	-	2	-	1	-	-	1	11
SHKODRA	2	46	73	34	18	13	20	16	11	5	7	-	3	3	-	251
KORÇA	1	-	3	1	2	4	7	2	4	2	3	1	1	3	1	35
ELBASANI	1	2	3	4	1	1	1	1	1	1	-	-	-	-	-	16
VLORA	-	1	1	-	-	-	1	1	-	-	-	-	-	-	-	4
BERATI	3	6	1	2	-	12	3	5	-	-	-	-	-	1	-	33
PESHKOPIJA	-	1	-	-	1	-	1	1	-	-	-	-	-	-	-	4
DURRËSI	-	6	27	11	2	4	1	2	-	-	-	-	-	4	-	57
TIRANA	1	-	3	8	-	-	-	-	11	-	1	-	-	-	2	26
Shuma e përmuajshme	50	62	112	69	36	36	45	30	30	10	10	2	4	13	6	516

Burimi: AMB, F. 4/shtabi, V. 1946, D. 6, fl. 12.

Përfundime

Që në vendimet e Kongresit të Përmetit, 24-28 maj 1944 u pa qartë që Partia Komuniste Shqiptare ishte e vendosur të mos bënte asnjë kompromis në ndarjen e pushtetit me forcat e tjera politike që vepronin në vend. Lëvizja Nacionalçlirimtare nën drejtimin e Partisë Komuniste Shqiptare e cila kishte marrë stafetën e udhëheqjes së luftës kundër pushtuesit, pësoi dekadencë, dhe u kthye në një lëvizje e cila sulmonte dhe demaskonte për qëllime politike kundërshtarët e PKS-së. Edhe në mbledhjen e Beratit 23-27 nëntor 1944, dëshmohej vijimi i sistemit represiv dhe demaskimi politik i kundërshtarëve të PKS-së, si e vetmja rrugë në forcimin e pozitave të Partisë Komuniste.

Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar, i dalë nga vendimet e Kongresit të Përmetit, u bë organi më i lartë legjislativ. Në vitin 1944-1945, vetë Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar nxori disa ligje si: Krijimi i gjyqeve speciale ndaj kundërshtarëve, sekuestrimet e pasurive të të arratisurve politikë, konfiskimin e pasurive të shtetasve të huaj, tatimin e jashtëzakonshëm etj.

Këto ligje, si shumë ligje të tjera të kësaj periudhe, për nga përmbajtja, mënyra e aplikimit, kujt i drejtoheshin, si dhe kë përfshinin, më rezultoi se nuk ishin gjë tjetër veçse ligje represive, të cilat shënjestruan kryesisht kundërshtarët politikë. Në prag të ardhjes në pushtet të PKS-së, si dhe me marrjen nën kontroll të institucioneve, shumë kundërshtarë të PKS-së, me qëllim shmangien e arrestimit dhe përndjekjen e tyre, u detyruan të lënë vendin dhe të arratisen jashtë Shqipërisë. Ata u strehuan në Itali, Francë, Austri, Greqi etj, dhe atje zhvilluan veprimtarinë e tyre jetësore dhe politike në ilegalitet.

Me hyrjen e qeverisë provizore në Tiranë (28 nëntor 1944) filloi menjëherë vala e arrestimeve dhe e burgosjeve të kundërshtarëve politikë të PKS-së nga forcat e Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit dhe të strukturës operacionalo-ushtarake të quajtur Divizioni i Mbrojtjes së Popullit, të cilat raportonin në mënyrë periodike pranë instancave shtetërore prej nga vareshin. U arrestuan shumë personalitete politike si Bahri Omari, Koço Kota, Bedri Pejani, por edhe njerëz të tjerë pa ndonjë veprimtari të dukshme politike, të cilët u arrestuan vetëm për faktin që nuk kishin qenë përkrahës të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga PKS-ja.

Nga këto forca u ndërmorën disa operacione ndëshkuese në Veriun e Shqipërisë që cilësohej si streha e grupeve nacionaliste, përkrahës të Ballit Kombëtar dhe Legalitetit me synim kapjen dhe dënimin e tyre. Nga forcat e Ushtrisë, Divizionit dhe Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit, shumë vende si: Koplik, Postribë, Shënpal, Kelmend, Lezhë, Mirditë iu nënshtruan çarmatimit të popullsisë, arrestimeve në masë, duke nënshtruar shumë krahina dhe duke i vendosur nën kontrollin e tyre. Pavarësisht shtypjes sistematike, krerët e atyre krahinave u mobilizuan kundër

forcave komuniste duke bërë dy kryengritje, si ajo e Koplikut dhe e Postribës. Me shtypjen e kryengritjes së Postribës në shtator të vitit 1946, pothuajse u shua çdo lloj shprese për përmbysjen e regjimit komunist dhe vendosjen e rendit liberal.

Duhet nënvizuar fakti se i gjithë sistemi represiv që u krijua, mbahej në saj të institucioneve të dhunës si Ushtria Nacionalçlirimtare, e cila u krijua me qëllim për të luftuar kundër pushtuesve fashist dhe nazist, por prej 1943 kthehet në një mjet dhune për të goditur kryesisht kundërshtarët. Institucione të tjera të dhunës ishin Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit, Divizioni i Mbrojtjes së Popullit, si dhe Komisioni Qendror i kriminelëve të luftës.

Komisioni Qendror për kriminelët e luftës që u krijua më 22 dhjetor 1944, iu largua qëllimit për zbulimin dhe hetimin e gjithë personave që kishin kryer krime lufte pa dallime politike. Nga një komision kundër kriminelëve të luftës, u kthye në një komision kundër kundërshtarëve të PKSH-së dhe qeverisë komuniste.

Bibliografia

Burime arkivore

AQSH, F. 14/AP-ou, V. 1944, D. 2/1.

AQSH, F. 14/AP-Str, V. 1946, D. 50.

AQSH, F. 40/APL, V. 1944, D. 19.

AQSH, F. 40/APL, V. 1944, D. 37.

AQSH, F. 41/APL, V. 1944, D. 56.

AQSH, F. 41/APL, V. 1944, D. 103.

AQSH, F. 210/APL, V. 1944, D. 20.

AQSH, F. 411/Ap, V. 1949, D. 1.

AQSH, F. 411/Ap, V. 1949, D. 6.

AQSH, F. 516, V. 1945, D. 2.

AQSH, F. 516, V. 1945, D. 17.

AMB, F. 1, D. 225/5 (fashikull), Vol. I.

AMB, F. 1, D. 1083-A (1).

AMB, F. 1, D. 1083-A (2).

AMB, F. 1, V. 1945, D. 12551 + 1568.

AMB, F. 4/shtabi, V. 1946, D. 6.

AMB, F. 4/shtabi, V. 1948, D. 23.

AMB, F. 4/dega e bandave, V. 1962, D. 166.
AMB, F. 8, V. 1946, D. 62.
AMB, F. 50, V. 1946, D. 114.
AMB, F. 59, V. 1945, D. 2.
AMB, F. 59, V. 1945, D. 4.
AMB, F. 140, Pa vit, D. 211-A.
AMB, F. 140, D. 1760 (Materiale të bandës së AlushLleshanakut, Vëll. VI).
ASHV/Dibër, F. 1, V. 1945, D. 4.
ISKK, F. 1, D. Dosja e enciklopedisë së viktimave të terrorit komunist.

Gazeta dhe revista

Gazeta Zyrtare, V. I, nr. 2, Tiranë, 23 dhjetor 1944.
Gazeta Zyrtare, V. II, nr. 24, Tiranë, 24 korrik 1945.
Gazeta Zyrtare, V. II, nr. 3, Tiranë, 23 kallnor 1945.
Gazeta Zyrtare, V. II, nr. 3-bis, Tiranë, 23 janar 1945.
Annual Review of Political Science, Vol. 10, Annual Reviews, Inc., U.S, 30 June 2007.
Revija 92, Beograd, 1974.
Studime historike, V. LIII (XXXVI), nr. 1-2, Tiranë, 1999.

Literatura bibliografike

Boriçi, Gjon. “Përpyjekjet e Sigurimit të Shtetit për të vënë nën kontroll emigracionin politik shqiptar në vitet 1945-1974”, në *Emigracioni politik shqiptar në vitet 1944-1990*. Tiranë: Onufri, 2021.
Bushaj, Eljaz. *Një vështrim rreth kryengritjes së Postribës: 9 shtator 1946*. Tiranë: Emal, 2011.
Butka, Uran. *Kryengritjet e para kundërkomuniste*. Tiranë: ISKK, 2013.
Butka, Uran. *Ringjallje*. Tiranë: Phoenix, 1995.
Dervishi, Kastriot. *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*. Tiranë: 55, 2006.
Dode, Luan. *Partia Komuniste Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore (nëntor 1941 - nëntor 1944): rrënjët e diktaturës komuniste në Shqipëri*. Tiranë: ISKK, 2020.

Fischer, Bernd J. *Shqipëria 1943-1945: një vështrim përmes dokumenteve perëndimore*. Tiranë: AIIS, 2012.

Fjalor enciklopedik i viktimave të terrorit komunist, Vëll. IV (I-K). Tiranë: ISKK, 2015.

Hasani, Sinan. *Kosova: të vërtetat e mashtrimet*. Prishtinë: Rilindja, 1986.

Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX (1939-1944), Vëll. IV. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2021.

Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX (1945-1999), Vëll. V. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2023.

Lalaj, Ana. “Pushteti dhe ‘tjetri’ që është përballë (Montimi i regjimit komunist në Shqipëri, 1944-1954)” në *Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri, 1945-1990*. Tiranë: Albtipografia, 2019.

Pandelejmoni, Enriketa. “Kriminelët e luftës”: emigracioni politik shqiptar në Itali dhe raporti me shtetin komunist shqiptar 1945-1955”, në *Emigracioni politik shqiptar në vitet 1944-1990*. Tiranë: Onufri, 2021.

Pllumi, Át Zef. *Rrno vetëm për me tregue*, Botimi V. Shkodër: Botime Françeskane, 2020.

Saraçi, Alvin. *Konfiskimi i pronës dhe grabitja e arit 1944-1955*. Tiranë: ISKK, 2012

Sartori, Giovanni. *The Theory of Democracy Revisited*. New Jersey: Chatham House Publishers, 1987.

Sufaj, Femi. *Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri gjatë regjimit komunist 1945-1990*. Tiranë: Dita 2000, 2014.

Syla, Sabit & Lita, Qerim. *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1944-1948*, Vëll. I. Prishtinë: Instituti i Historisë, 2020.

Zyberaj, Florin. *Dokumente mbi Divizionin e Mbrojtjes së Popullit 1944-1946*, Vëll. I. Tiranë: ISKK, 2022.

Web

Komisioni Qendror i Kriminelëve të luftës, i disponueshëm në: <https://www.facebook.com/institutistudimevehistorikelumoskendo/posts/pfbid02CfHYj3s5wqznys2sjBFHjBTEYGPjMJNLpëqi2zMEHtMjiG8Nph5m2DKw2f2ntDmHl>, aksesuar, më 22 dhjetor 2023.

Životopis Bedri Pejani, i disponueshëm në: https://wikijii.com/wiki/Bedri_Pejani aksesuar, më 2 shkurt 2024.